

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS LEZHË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën e Doganës Lezhë, me objekt “Mbi zbatimin e legjislacionit doganor dhe vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën 01.01.2013 – 31.12.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 27, datë 25.03.2015.

Bazuar në nenet 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 1209/7, datë 25.03.2015, për zj. Lula Njebza me detyrë Kryetare e Degës së Doganës Lezhë dhe shkresën nr. 1209/8, datë 25.03.2015, për zj. Irena Beqiraj me detyrë Drejtore e Përgjithshme e Doganave, Tiranë i janë dërguar “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi u konstatua se autoriteti doganor referuar rekomandimeve të KLSH nga auditimi i mëparshëm, të dërguara me shkresën nr. 76/8 prot. datë 30.04.2013 nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e auditit të mëparshëm, në lidhje me praktikat doganore ku rezultojnë diferenca në peshë, problematikë e cila u konstatua përsëri gjatë këtij auditimi, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 10-12 të Raportit të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Lezhë të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të auditit të mëparshëm të KLSH.

Menjëherë

2. Nga auditimi rezulton se borxhi doganor është **shtuar me 18 raste dhe në vlerë është shtuar me 1,426,476 mijë lekë** ku disa masa për rikuperimin e tij kanë rezultuar jo efektive, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 245 të Kodit Doganor; nenit 103.1/a/b, 103.2/2 dhe 103.3/5/5 të ligjit 61/2012 “Për akcizat në RSH” si dhe Udhëzimit nr. 4 datë 04.08.2006 i ndryshuar me Udhëzimin nr. 11569/2 prot datë 23.07.2013 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe akcizës”, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 39-41 të Raportit të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Lezhë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masat përkatëse sipas kërkesave ligjore dhe ato në kuadrin e marrëveshjeve ekzistuese apo nëpërmjet krijimit të marrëveshjeve të reja me institucionet e tjera, për të bërë të mundur rikuperimin e borxhit doganor.

Në vijimësi

3. Nga auditimi rezulton se përdorimi i ambienteve private për zyra nga administrata e Degës Doganore Lezhë, për një periudhë kohore me mbi 12 vite, me pagesë mujore **300 mijë lekë**, është një shpenzim i pa studiuar dhe pa efektivitet, *trajtuar më hollësisht në faqen nr. 53 të Raportit të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Lezhë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masat për të parë mundësinë e sistemimit në ambiente të tjera, pronë e enteve shtetërore apo ndërtimin e tyre me synim mënjanimin e e shpenzimeve të tilla të mëdha që vazhdojnë të kryhen për përballimin e qerave të larta mujore.

Menjëherë

4. Nga auditimi i të ardhurave rezulton se nuk ka një planifikim apo ndjekje të treguesit të të ardhurave që sigurohen nga zëri i rentës minerare, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e pikës 4 të nenit 9, nenit 23 dhe 24 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 12-14 të Raportit të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Lezhë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa për një planifikim të saktë të ardhurave sipas zërave me qëllim ngritjen në një nivel më të lartë të realizimit të objektivave në fushën e realizimit të ardhurave.

Në vijimësi

5. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me arkiv-protokollin rezultoi se subjekti **SHPK** me NIPT **.....** me seli në Lezhë, me DAV me R-**.....**, datë 01.05.2013 ka deklaruar dhe kryer procedurat doganore pranë Degës së Doganës Durrës, artikull jo në kodin e duhur tarifor, me pasojë shmangien e detyrimeve doganore në vlerën 304,338 lekë, veprim ky jo në përputhje me kërkesat e nenit 12.1; 256.1/a; 256.2; 256.4; 261.1 dhe 261.2 të Kodit Doganor për të cilin nga Autoriteti Doganor Durrës është dalë me Vendim Administrativ nr. 208, datë 17.02.2015, *trajtuar më hollësisht në faqen nr. 55 të Raportit të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Drejtoria e Përgjithshme të Doganave, (Departamenti Operativ Hetimor), të hetojë shkeljet në lidhje me perpunimin e kësaj praktike doganore dhe në bashkëpunim me Degën e Doganës Durrës të marrë masa për të vënë para përgjegjësisë personat përgjegjës.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportin e Auditimit, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit dhe vjeljes së borxhit doganor në vlerën **45,755,015 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

B.1. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me arkiv-protokollin rezultoi se subjekti **SHPK** me NIPT **.....** me seli në Lezhë, me DAV me R-**.....**, datë 01.05.2013 ka deklaruar dhe kryer procedurat doganore pranë Degës së Doganës Durrës, artikull jo në kodin e duhur tarifor me pasojë shmangien e detyrimeve doganore veprim ky, jo në përputhje me kërkesat e nenit 12.1; 256.1/a; 256.2; 256.4; 261.1 dhe 261.2 të Kodit Doganor për të cilin nga Autoriteti Doganor Durrës është dalë me Vendim Administrativ nr. 208, datë 17.02.2015, *trajtuar më hollësisht në faqen nr. 55 të Raportit të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim vjeljen e borxhit doganor në vlerën **1,217,352 lekë**, duke nxjerrë dhe përgjegjësitë në lidhje me personat përgjegjës.

Menjëherë

B.2. Nga Dega e Doganës Lezhë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit dhe vjeljes së borxhit doganor në vlerën **44,537,663 lekë**; në mënyrë analitike si më poshtë:

B.2.1 Nga auditimi i dokumentacionit për vendimet administrative të marra për shkeljet në fushën doganore dhe të akcizës rezultuan vendime të marra me minimumin e penaltetit edhe pse subjekti shkelës ka qenë përsëritës; vetëm për detyrimin doganor të lindur por pa penaltitet; jo për çdo shkelje në veçanti si dhe në rastet e ushtrimit të kontrollit fizik të deklarimeve kur janë konstatuar artikuj tepër deklarimit nuk është bërë konfiskimi i këtyre artikujve veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a, 256.2, 275.1, 273.2, 261.1 dhe 287.2/f të Kodit Doganor si dhe nenit 86.2; 85.1/a; 85.2 dhe 91.5 të ligjit 61/2012, datë 01.10.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 41 - 47 të Raportit të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Lezhë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **13 raste**, në vlerën **21,626,641 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 5 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

B.2.2. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me arkiv-protokollin rezultuan shkresa dhe procesverbale të mbajtura për shkelje në fushën doganore dhe të akcizës për të cilat Autoriteti Doganor kompetent nuk ka dalë me Vendim Administrativ veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 287.1 dhe 289.1 të Kodit Doganor si dhe nenit 98.1 dhe 99 të ligjit nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 53 - 58 të Raportit të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Lezhë të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **18 raste**, në vlerën **10,110,216 lekë** dhe vjeljes së borxhit doganor **për 1 rast**, në vlerën **171,926 lekë** (për të cilën, pas konstatimit nga grupi i auditimit, Autoriteti Doganor ka dalë me Vendimet Administrative nr. 24 dhe nr. 25, datë 16.02.2015), **në total 19 raste në vlerën 10,282,142 lekë**, nga subjektet sipas aneksit nr. 6 dhe 7 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

B.2.3. Nga auditimi i dokumentacionit tregtar dhe procedurave të ndjekura në deklarimin e mallrave, rezultuan raste të keqklasifikimit të artikujve; shqyrtim jo si duhet i vlerës doganore të mallrave dhe trajtim me MSABE me nivel të taksës doganore 0 % për artikuj që nuk plotësojnë kriteret, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e neneve 34-37, 256.2, 256.4, 261.1, 261.2 të Kodit Doganor si dhe Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”, nxjerrë për këtë qëllim, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 14 - 36 të Raportit të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Lezhë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **72 raste**, në vlerën **9,704,521 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 1, 2 dhe 3 të Raportit të Auditimit.

Brenda datës 30.04.2015

B.2.4. Nga auditimi i dokumentacionit për autorizimet e përjashtimeve nga detyrimet doganore dhe TVSH rezultoi se janë lëshuar autorizime për individë pa plotësuar kriteret e ndryshimit të rezidencës së banimit, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 199.2/a të Kodit Doganor; pikave 485-492 të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor, “Për përjashtimin nga Taksa Doganore” Udhëzimit nr. 9475/1, datë 01.08.2008, “Për përjashtimin nga Taksa

Doganore” si dhe me mbarimin e afatit të shtyrjes së TVSH, nga ana e subjekteve nuk është bërë pagesa, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 256.1/a, 256.2, 256.4 të Kodit Doganor, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 58-74 të Raportit të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Lezhë të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **28 raste**, në vlerën **2,207,957 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 8 të Raportit të Auditimit.

Brenda datës 30.04.2015

B.2.5. Nga auditimi i dokumentacionit tregtar; praktikave doganore të përzgjedhura të subjekteve të cilët kanë operuar në kushtet e autorizimeve të regjimeve ekonomike rezultuan importe të artikujve të pa përfshirë në autorizim veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 256.1/a, 256.2, 256.4, 275.1, 275.2 dhe 287.2/f të Kodit Doganor; kërkesat e nenit 300.1/2/3 të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor si dhe kërkesat e nenit 11.1 të Udhëzimit 1 (nr. 12403/2 prot.), datë 06.09.2012 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, *“Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”*, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 37 - 39 të Raportit të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Lezhë të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **2 subjekte**, në vlerën **716,402 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 4 të Raportit të Auditimit.

Brenda datës 30.04.2015

C. MASA ADMINISTRATIVE

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me vlerësimin doganor rezultoi se nga **5 agjenci doganore**, që operojnë pranë Degës së Doganës Lezhë, janë keqklasifikuar artikuj me pasojë shmangien e detyrimeve doganore, në shkelje të neneve 256.1/a; 256.2; 275.1; 261.1; 261.2 dhe 261.3 të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 17- 25, 29, 35 dhe 54-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Për këtë është rekomanduar që Dega e Doganës Lezhë, mbështetur në faktet e vërtetuara dhe në të dhënat e grumbulluara gjatë auditimit, të marrë masa bazuar në nenet 275.1 dhe 287.2/f të Kodit Doganor, për penaltet në masën **nga 50,000 lekë deri në 200,000 lekë**, për **5 agjencitë doganore**.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

D.1. Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtores së Përgjithshme të Doganave të fillojë procedurat për të kaluar në Komisionin Disiplinor, sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 për shkeljet e konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda, të urdhërojë fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe dhënien e masës përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

1. Për z. [REDACTED] me detyrë ish-Kryetar i Degës së Doganës Lezhë, aktualisht Kryetar i Degës së Doganës Fier, për veprimet jo në përputhje me nenin 13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore në përmbushje të detyrave funksionale në total për **22 (njëzetë e dy) raste**.
(Trajtuar hollësisht në faqet 38-41; 44-47; 54; dhe 67-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

D.2. Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtores së Përgjithshme të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganës, Lezhë që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 të konsideruara nga ana jonë si shkelje shumë të rënda dhe të rënda, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

a. Neni 58 gërma “ç”, “Largim nga shërbimi civil”:

1. Për z. [REDACTED] me detyrë përgjegjës sektori operacionesh në Degën e Doganës Lezhë, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 15.3 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, për 45 raste për problemet e konstatuara në lidhje me:

- Trajtimin me MSABE të mallrave, jo në përputhje me kërkesat e Titullit V, neni 21, kushtet për lëshimin e një deklarate faturë “...Një deklaratë faturë mund të përgatitet nga një eksportues i aprovuar në kuptim të nenit 22 ose nga një eksportues i një dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese, vlera e të cilave nuk i kalon 6000€...” dhe Udhëzimit nr.5883prot, datë 16.05.2006 të D.P.D për “Dokumentacionin e detyrueshëm për vërtetimin e origjinës preferenciale”;

-Praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion, jo në përputhje me kërkesat e Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”, nxjerrë për këtë qëllim;

- Praktika doganore të cilat janë trajtuar me origjinë preferenciale me tarifë doganore 0% ku referuar faturës, nuk i përmbush kriteret për një deklaratë faturë sipas tekstit të përcaktuar (nota shpërndarëse), në kërkesat e Shtojcës (Aneksit) 4 të Protokollit të Origjinës si dhe nenit 22.4 të Udhërrëfyesit “Mbi rregullat e Origjinës Preferenciale...sipas MTL” si dhe Udhëzimit nr. 5883prot, datë 16.05.2006 për “Dokumentacionin e detyrueshëm për vërtetimin e origjinës preferenciale”, në shkelje të nenit 256.1/a, 256.2, 256.4 dhe 261.1 të Kodit Doganor;

- Praktikë doganore trajtuar me keqklasifikim të kodit tarifor me pasojë shmangien e detyrimeve doganore në shkelje të nenit 256.1/a, 256.2, 256.4; 261.1 dhe 261.2 të Kodit Doganor.

- Praktika doganore ku referuar “Dosjes së të dhënave të disponueshme për shpenzimet e transportit...”, janë trajtuar jo në përputhje me kërkesat për vlerën e transportit;

- Dhënien e autorizimeve për përjashtimin nga detyrimet doganore pa dokumentacionin përkatës si kusht për të përfituar përjashtimin nga pagesa e detyrimeve doganore, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 199.2/a të Kodit Doganor; pikave 485-492 të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor, “Për përjashtimin nga Taksa Doganore” si dhe me kërkesat e Udhëzimit nr. 9475/1, datë 01.08.2008 “Për përjashtimin nga Taksa Doganore”.

(Trajtuar hollësisht në faqet 14-36; 46-47 dhe 70-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

b. Neni 58 gërma “a - ç”, nga “Vërejtje” deri “Largim nga shërbimi civil”:

1. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë doganier klasifikim/vlerë në Degën e Doganës Lezhë, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 15.13 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, për 72 raste për problemet e konstatuara në lidhje me:

- Trajtimin me MSABE të mallrave, jo në përputhje me kërkesat e Titullit V, neni 21, kushtet për lëshimin e një deklarate faturë “...Një deklaratë faturë mund të përgatitet nga një eksportues i aprovuar në kuptim të nenit 22 ose nga një eksportues i një dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese, vlera e të cilave nuk i kalon 6000€...” dhe Udhëzimit nr.5883prot, datë 16.05.2006 të D.P.D për “Dokumentacionin e detyrueshëm për vërtetimin e origjinës preferenciale”;

- Praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion, jo në përputhje me kërkesat e Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”, nxjerrë për këtë qëllim;

- Praktika doganore të cilat janë trajtuar me origjinë preferenciale me tarifë doganore 0% ku referuar faturës, nuk i përmbush kriteret për një deklaratë faturë sipas tekstit të përcaktuar (nota shpërndarëse), në kërkesat e Shtojcës (Aneksit) 4 të Protokollit të Origjinës si dhe nenit 22.4 të Udhërrëfyesit “Mbi rregullat e Origjinës Preferenciale...sipas MTL” si dhe Udhëzimit nr.5883prot, datë 16.05.2006 për “Dokumentacionin e detyrueshëm për vërtetimin e origjinës preferenciale”, në shkelje të nenit 256.1/a, 256.2, 256.4 dhe 261.1 të Kodit Doganor;

- Praktikë doganore trajtuar me keqklasifikim të kodit tarifor me pasojë shmangien e detyrimeve doganore në shkelje të nenit 256.1/a, 256.2, 256.4; 261.1 dhe 261.2 të Kodit Doganor.

- Praktika doganore ku referuar “Dosjes së të dhënave të disponueshme për shpenzimet e transportit...”, janë trajtuar jo në përputhje me kërkesat për vlerën e transportit;

- Praktika doganore me probleme të të njëjtit subjekt, të përpunuar po nga punonjësi i sipërcituar.

(Trajtuar hollësisht në faqet 14-36 dhe 54-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

c. Neni 58 gërma “b”, “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”:

1. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë ish-përgjegjës sektori operacionesh, aktualisht jurist/specialist borxhi në Degën e Doganës Lezhë, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 15.3 dhe 14/5 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, për 18 raste për problemet e konstatuara në lidhje me:

- Praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion, jo në përputhje me kërkesat e Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”, nxjerrë për këtë qëllim;

- Praktikë doganore trajtuar me keqklasifikim të kodit tarifor me pasojë shmangien e detyrimeve doganore në shkelje të nenit 256.1/a, 256.2, 256.4; 261.1 dhe 261.2 të Kodit Doganor;

- Praktika doganore ku referuar “Dosjes së të dhënave të disponueshme për shpenzimet e transportit...”, janë trajtuar jo në përputhje me kërkesat për vlerën e transportit;

- Konceptimin e vendimeve administrative në lidhje me klasifikimin e shkeljeve doganore.

(Trajtuar hollësisht në faqet 15; 31; 42-47; 54-55 dhe 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Shënim:

I. Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk rekomandohet masë për 3 ish-punonjësit e poshtë cituar, pasi janë të larguar nga sistemi doganor.

1. z. [REDACTED] në cilësinë e ish-përgjegjës sektori operacionesh, për 42 raste;
2. z. [REDACTED] në cilësinë e ish-kryetar i Degës Doganore për 14 raste;
3. z. [REDACTED] në cilësinë e ish-specialist i sektorit a-posterior; ish-doganier regjime/akcizë/përrjashtime për 4 raste.

II. Duke analizuar mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, mbi numrin e rasteve si dhe natyrën e këtyre të metave dhe mangësive, për punonjësit me numër rastesh 1-3, nuk rekomandohet masë disiplinore.

Shënim: Auditimi u krye përgjatë periudhës 05.01.2015 deri më 13.02.2015, nga audituesit Agron Opari, p/grupi, Bashkim Shehu dhe Marvin Karalli, u mbikëqyr nga Kryeauditues z. Vullnet Karafilaj, më tej u shqyrtua nga Drejtori i Departamentit zj. Albana Agolli dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT